



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4333/ prot.
4

Laç, më 06 /10 2025

VENDIM

Nr 32 Datë 30/08/2025

”PËR MIRATIMIN E LISTES SË PËRFITUESVE QË KANË APLIKUAR NË PLATFORMEN ONLINE “SHTËPIA IME” PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE TË REJA”.

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, të ligjit nr.97/2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 40, datë 31.01.2020 “Për miratimin e platformës online të aplikimit për programet e rindërtimit dhe manualin e përdorimit të platformës, si dhe manualin e procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe të shkresës nr.4333/1 prot, datë 22.09.2025 “Raport i plotë me propozimin për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit, programi i zhvillimit të objekteve të reja”, të hartuar nga Komisioni i Posaçëm, pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI;

1. Miratimin e listës së përfituesve që kanë aplikuar në platformen online “Shtëpia ime” për të përfituar nga programi i procesit të rindërtimit, programi i zhvillimit të objekteve të reja, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Struktura e njësisë së banimit (apartament), që do t’i kalohet në pronësi përfituesve në ndërtesat e reja llogaritet sipas tabelës A bashkëlidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”. të ndryshuar.
3. Me përfitimin e strukture së njësisë së banimit (apartament) sipas listës bashkëlidhur projektvendimit, përfituesit humbasin të drejtën e pronësisë për banesën e mëparshme të dëmtuar nga dëmtuar nga termeti i datës 26.11.2019.
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike të njoftojë familjet që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit, programi i zhvillimit të objekteve të reja”, si dhe ata/ato që nuk kanë përfituar nga

ky program, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga Këshilli Bashkiak..

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .


Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Drejtoria e Sherbimeve Publike .

>Drejtoria e Financave

>Arkivit

Sekretari i Këshillit
Arber Leka



Kryetare e Këshillit
Edlira Lleshi

